

LIGJI Nr. 04/L-62 PËR FSHATIN HOÇË E MADHE

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR FSHATIN HOÇË E MADHE

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për mbrojtjen, administrimin dhe zhvillimin bashkëkohor të fshatit Hoçë e Madhe si pronë e trashëgimisë kulturore dhe fetare në mbrojtje të përhershme dhe të klasifikuar si zonë e veçantë e mbrojtur.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Me këtë ligj përcaktohet e drejta e autoritetit të kufizuar e Fshatit Hoçë e Madhe për mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe fetare si dhe të planifikimit rural në pajtim me ligjet në fuqi.

**Neni 3
Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Trashëgimia kulturore** - trashëgimia arkitekturale, trashëgimi arkeologjike, trashëgimi e luajtshme dhe trashëgimia shpirtërore, siç është përcaktuar në Ligjin Nr. 02/L-88/2006 për Trashëgiminë Kulturore.

1.2. **Planifikimi Rural** - planifikimi për shfrytëzimin, mbrojtjen, rregullimin dhe menaxhimin e hapësirës ose territorit të përkufizuar si "Fshat" me Ligjin për Planifikimin Hapësinor Nr. 2003/14.

1.3. **Promovimi** - aktivitetet reklamuese për të propaganduar vlerat e një monumenti të trashëgimisë kulturore me qëllim të rritjes së numrit të vizitorëve dhe njohurinë për të.

1.4. **Mbrojtja** - është një nomenklaturë e masave të mbrojtjes të natyrës juridike me qëllim të ruajtjes së vlerave të trashëgimisë kulturore, siç është parashikuar me Ligjin Nr. 02/L-88/2006 për Trashëgiminë Kulturore.

1.5. **Konservimi** - krijimi i kushteve të përshtatshme dhe marrjen e masave paraprake për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, duke përfshirë edhe mirëmbajtjen, siç parashihet me Ligjin Nr. 02/L-88/2006 për Trashëgiminë Kulturore.

1.6. **Plani i Konservimit** - dokumenti i planifikimit hapësinor për konservimin, përdorimin dhe zhvillimin në të ardhmen të një hapësire me vlera të trashëgimisë kulturore.

- 1.7. **IKMM** - Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve.
- 1.8. **Fshati** - fshati Hoçë e Madhe të Komunës së Rahovecit.
- 1.9. **ZVM** - Zona e veçantë të mbrojtur e fshatit Hoçë e Madhe, siç përkufizohet me Ligjin Nr. 03/L-039/2008 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura.
- 1.10. **Këshilli** - Këshilli për fshatin Hoçë e Madhe, të themeluar nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit në pajtim me këtë Ligj.
- 1.11. **Komuna** - Komuna e Rahovecit ashtu siç është përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale.
- 1.12. **Kuvendi i Komunës** - organi më i lartë të Komunës së Rahovecit që përbëhet prej anëtarëve të tij të zgjedhur siç është përkufizuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale.
- 1.13. **KZM** - Këshilli për Zbatim dhe Monitorim siç përkufizohet me Ligjin Nr. 03/L-039/2008 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura.
- 1.14. **PZHK** - Plani Zhvillimor i Komunës së Rahovecit.
- 1.15. **Autoriteti i kufizuar** - autoriteti që ushtrohet nga Këshilli pa paragjykim ndaj Ligjit për ZVM.

Neni 4 Këshilli

1. Këshilli përfaqëson interesat e Fshatit në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë fetare dhe kulturore dhe në fushën e planifikimit rural.
2. Këshillin e themelon Kuvendi i Komunës në pajtim me nenin 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale.
3. Këshilli përbëhet prej pesë (5) anëtarëve:
 - 3.1. dy (2) anëtarë zgjedhën nga Kuvendi i Komunës;
 - 3.2. dy (2) anëtarë zgjedhën drejtpërdrejtë nga banorët e fshatit Hoçë e Madhe;
 - 3.3. një anëtarë (1) zgjidhet nga Kisha ortodokse serbe, i cili duhet të jetë anëtarë i fshatit Hoçë e Madhe.
4. Zgjedhja e Këshillit organizohet nga Kuvendi i Komunës përmes ftesës publike në pajtim me legjislacionin në fuqi.
5. Anëtarët e Këshillit zgjedhën me mandatin e njëjtë të anëtarëve të Kuvendit të Komunës me të drejtë rizgjedhjeje.
6. Kuorumi për të gjitha takimet e Këshillit përbëhet prej së paku gjysmës së Anëtarëve të Këshillit.
7. Këshilli mund të marr vendim nëse për të voton shumica e anëtarëve që janë të pranishëm.
8. Këshilli e zgjedh Kryesuesin nga anëtarët e tij, i cili duhet të jetë banor i fshatit, zgjedhja e të cilit bëhet me vota të fshehta të Këshillit.

9. Këshilli dhe Kryesuesi i Këshillit ushtrojnë veprimtaritë e tyre në bazë të vendimeve të nxjerra nga Kuvendi i Komunës dhe në bazë të autorizimeve që ua jep ky Ligj.

10. Buxheti për themelimin dhe funksionimin e Këshillit ndahet në pajtim me Ligjin mbi Financat lokale, i cili i ofrohet Komunës si grand për kompetencat e shtuara.

Neni 5

Marrëdhënia ndërmjet Këshillit dhe Autoriteteve Komunale dhe Qendrore

1. Komuna ose autoriteti qendror i shqyrtojnë kontributet, vlerësimet dhe propozimet/rekomandimet e Këshillit siç përcaktohet me legjislacionin në fuqi.
2. Komuna, në konsultim me institucionet përkatëse të trashëgimisë kulturore dhe në bashkëpunim me Këshillin hartojnë dhe miratojnë dokumentet e planifikimit për Fshatin në përputhje me legjislacionin relevant: Ligjin Nr. 2003/14 për Planifikimin Hapësinor dhe Ligjin Nr. 03/L-106 për Ndryshimin e Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 2003/14 dhe Ligjin Nr. 02/L-88/2006 për Trashëgiminë Kulturore dhe fetare, Konventën e UNESCO për trashëgimi kulturore dhe natyrore, Deklaratën universale të UNESCO për diversitetin kulturor dhe traktatet relevante të BE.
3. Me qëllim të zbatimit të paragrafit 2 të këtij neni, Komuna zhvillon një qasje të integruar ndaj ZVM-së dhe rrethinës së saj, duke respektuar strukturën dhe karakterin e saj.
4. Këshilli, sipas nevojës, mund të kërkojë mbështetje nga Kuvendi i Komunës dhe Qeveria Qendrore të cilat sigurojnë mbështetje për zbatimin e të drejtave dhe autorizimeve sipas këtij Ligji.
5. Në rast të mosmarrëveshjeve në mes të Këshillit dhe autoriteteve komunale, për çështjet që kanë të bëjnë me ushtrimin e autoritetit të kufizuar të fshatit sipas neneve 6,7 dhe 9 të këtij Ligji, palët i referojnë në KZM, dhe nëse është e arsyeshme në institucionet kompetente qendrore dhe në Gjykatën kompetente, për shqyrtim.

Neni 6

Autoriteti i kufizuar lidhur me aktivitetet për mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë fetare dhe kulturore

1. Këshilli ka të drejtë që në konsultim dhe bashkëpunim me organet kompetente të Komunës të ushtrojë aktivitetet që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë fetare dhe kulturore:
 - 1.1. organizimit, kontribuimit dhe monitorimit të aktiviteteve gjatë hartimit të planit për konservim të Fshatit, në bashkëpunim me IKMM dhe në pajtim me Ligjin Nr. 02/L-88/2006 për Trashëgiminë Kulturore, si dhe me Konventën e UNESCO-së për trashëgiminë kulturore dhe natyrore, deklaratën universale të UNESCO-së për diversitetin kulturor dhe Traktatet relevante të BE.
 - 1.2. monitorimit dhe vlerësimit të gjendjes së trashëgimisë kulturore në Fshat.
 - 1.3. propozimit IKMM -së të masave që duhet ndërmarrë për mbrojtje, promovim dhe zhvillim të trashëgimisë kulturore në pajtim me Ligjin për Trashëgiminë Kulturore.
 - 1.4. hartimit të programeve promovuese për trashëgiminë kulturore në bashkëpunim me IKMM-në.

Neni 7
Autoriteti i kufizuar për aktivitetet në fushën e planifikimit rural

1. Këshilli ka të drejtë, që në konsultim dhe në bashkëpunim me organin kompetent të Komunës të ushtrojë autoritet të kufizuar në aktivitetet e fushës së planifikimit rural përmes:

- 1.1. pjesëmarrjes në hartimin e dokumenteve të planifikimit rural të Fshatit;
- 1.2. pjesëmarrjes në hartimin e PZHK-së.

Neni 8
Konservimi i strukturës dhe karakteristikave të Fshatit

1. Me qëllim të ruajtjes së strukturës dhe karakteristikës së veçantë të fshatit me planin e konservimit, ndalohen përkatësisht kufizohen këto aktivitete:

- 1.1. ndërtimet apo zhvillimet industriale, siç janë kërkimi dhe shfrytëzimi i burimeve minerare dhe ndërtimi i digave, centraleve elektrike apo linjave të tensionit, furrave dhe fabrikave dhe rrugëve transite;
- 1.2. ndërtimet apo zhvillimet që çojnë në shpyllëzimin ose ndotjen e mjedisit;
- 1.3. urbanizimi i tokës bujqësore;
- 1.4. aktivitetet që do të rezultojnë në ndryshimin e përhershëm të profilit fizik të peizazhit natyror;
- 1.5. ndërtimi i pompave të benzinës;
- 1.6. bashkimi i dy ose më shumë parcelave kadastrale në një tërësi, e cila do të rezultonte me ngritjen e një objekti me sipërfaqe më të madhe se 90 m²;
- 1.7. aktivitetet e ndërtimit ose transformimit që do të rezultojnë në objekte që tejkalojnë lartësinë P +1 ose lartësia e të cilave është më e madhe se 7 m kur matet nga terreni natyror deri në nivelin e vijës së kulmit; ose lartësia e përgjithshme e të cilit kur matet nga terreni natyror, duke përfshirë vijën e kulmit dhe anekset e tjera fizike të ndërtesës, tejkalon 9.5 m;
- 1.8. aktivitetet e ndërtimit ose transformimit që do të rezultojnë në objekte sipërfaqja e katit përdhese e të cilave tejkalon 90 m², me përjashtim të rasteve të veçanta të rindërtimit ose rifunksionalizimit të objekteve, duke respektuar karakterin e ZVM-së;
- 1.9. vendosja e ekspozimeve të përhershme reklamuese, tabelave private, dekorimeve ose elementëve të tjerë pengues me sipërfaqe më të madhe se 1m².

Neni 9
Procedura e shqyrtimit të kërkesave për leje në kuadër të ZVM

1. Përveç kushteve për dhënie të lejeve që kërkohen sipas legjislacionit në fuqi, procedura për dhënien e kërkesave për leje në ZVM përfshin edhe ndërmarrjen e këtyre veprimeve:

- 1.1. Komuna i dorëzon Këshillit të gjitha kërkesat e shqyrtuara për leje brenda ZVM-së me rekomandimet e saj profesionale;

- 1.2. Këshilli i shqyrton të gjitha rekomandimet për leje në përputhje me ligjet në fuqi;
- 1.3. Këshilli mund të mos pajtohet me një rekomandim për leje vetëm nëse konsideron se ajo nuk është në përputhje me planet hapësinore dhe urbane dhe ligjet në fuqi;
- 1.4. Këshilli i shqyrton rekomandimin për leje, dhe e informon Komunën për pëlqimin ose refuzimin nga ana e tij brenda 15 ditësh;
- 1.5 Komuna i shqyrton rekomandimet e Këshillit në të gjitha rastet;
- 1.6. nëse Këshilli nuk përgjigjet brenda 15 ditësh, konsiderohet se rekomandimi i Komunës ka marrë pëlqimin nga Këshilli.

Neni 10 Dispozitat kalimtare

1. Anëtarët e Këshillit zgjedhën brenda gjashtë (6) muajsh nga hyrja në fuqi e këtij Ligji dhe vazhdojnë mandatin deri në zgjedhjet e ardhshme që zhvillohen në të njëjtën kohë me zgjedhjet lokale.
2. Asgjë në këtë Ligj nuk do të interpretohet si kufizim ose ndikim tjetër në të drejtat dhe imunitetet e garantuara me Kushtetutë.

Neni 11 Hyrja në fuqi

Ky ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/L-062
20 Prill 2012**

Shpallur me dekretin Nr.DL-034-2012, datë 09.07.2012 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.